



Pranuar / Dërguar Priljezja/Pradato Received/Delivered	11 - 05 2022	2	viti god year
Organ /Njësia Org /Jedinita Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Protog Appendix	Sasia Kohësira Quantity
SKPM/SHCK	2722/2022		1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.316/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.316/2022 të datës 31.03.2022 me numër protokollit 1761/2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë \_\_\_\_\_, kundër heshtjes administrative të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës-pezuillim i dakorduar", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 10.05.2022, mori këtë.

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.316/2022 e parashtruar me datë 31.03.2022 nga ankuesi
- II. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Prishtinës, që nga dita e pranimit të këtij vendimi brenda afatit ligjor prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh të bëjë zbatimin e tij duke e kthyer nëpunësin në pozitën e mëparshme "Udhëheqës i Sektorit Ligjor" në Departamentin e Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës sipas Akt Emërimit 01.Nr.112-1024 të datës 01.02.2017 ose në një pozitë ekuivalente.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ sipas të akt emërimit me 01.Nr.112-1024 të datës 01.02.2017 ka qenë e sistemuar në vendin e punës "Udhëheqës i Sektorit Ligjor" në Departamentin Kabineti i Kryetarit në Komunën e Prishtinës. Më datë 16.08.2017 Kryetari i Komunës nxjerr vendim me numër \_\_\_\_\_



01.nr.112/02-0203810/17 me anë të cilit nëpunësi civil caktohet Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, gjithashtu me datë 16.08.2017 Kryetari i Komunës nxjerr vendim me numër 14-112/02-0204360/17 për pezullim të dakorduar të nëpunësit civil.

Ankuesi, pas përfundimit të mandatit të tij në pozitën "Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit" në Komunën e Prishtinës, me datë 17.12.2021 parashtron kërkesë me numër 14-117/01-274345/21 tek Kryetari i Komunës së Prishtinës për kthimin në vendin e punës respektivisht të zbatimit të vendimit të datës 16.08.2017 me numër 14-112/02-0204360/17. Në bazë të provave të lëndës ankuesi nuk ka marr përgjigje në kërkesën e tij, kështu që bazuar në heshtjen administrative ankuesi, më datë 31.03.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 1761/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet për kthim në vendin e punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datës 13.04.2022 ankesën e ankuesit e ka dërguar tek Komuna e Prishtinës për përgjigje në ankesë. Më datë 21.04.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Prishtinës me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.Prot:1761/2022 të datës 31.03.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim për caktimin e Drejtorit të Drejtorisë së Urbanizmit me numër 01.nr.112/02-0203810/17 i datës 16.08.2017; Vendim për pezullim të dakorduar me numër 14-112/02-0204360/17 i datës 16.08.2017; Kërkesë me numër 14-117/01-274345/21 i datës 17.12.2021; Akt Emërim i A.O. me numër 01.nr.112-1024 i datës 01.02.2017; Akt Emërim i A.O. me numër 01-112-1024 i datës 25.09.2015; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 13.04.2022; Përgjigje në ankesë e datës 21.04.2022; Përshkrimi i Detyrave të Punës; E-mail nga M.Ll për C.Z. i datës 22.04.2022; Betimi i Kryetarit të Prishtinës i datës 07.12.2021;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e bazuar sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që në bazë të Vendimit me numër 14-112/02-0204360/17 të datës 16.08.2017 për pezullim të dakorduar të marrëdhënies së punës i është garantuar e drejta për kthim në vendin e punës apo në një pozitë ekuivalente, po ashtu ketë e garanton neni 89 i Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës dhe neni 55 paragrafi 2 i Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Fillimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se me dispozitat ligjore të Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka përcaktuar që nëpunësi civil mund të marr pozitë të funksionarit publik por duhet të bëjë pezullim të marrëdhënies së punës përderisa është i emëruar në atë pozitë, konkretisht neni 89 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, ka përcaktuar që: *"Për qëllime të këtij ligji, rastet në vijim konsiderohen pezullim i dakorduar nga shërbimi civil: 1.3. marrjes së detyrës së funksionarit publik"*, në këtë rast ankuesi meqë ka marr pozitën e funksionarit publik respektivisht "Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit" në Komunën e Prishtinës, atëherë ka bërë edhe pezullimin e marrëdhënies së punës si nëpunës civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se në bazë të Vendimit me numër 14-112/02-0204360/17 të datës 16.08.2017 për pezullim të dakorduar të





marrëdhënies së punës i është garantuar e drejta për kthim në vendin e punës apo në një pozitë ekuivalente, ka konstatuar se në bazë të këtij vendimi në pikën III është paraparë që *“Pas mbarimit të afatit të pezullimit të dakorduar , nëpunësi civil kthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në pozitë ekuivalente”*, si rrjedhojë, në bazë të dispozitave të nenit 89 para paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *“Pas mbarimit të kushtit të pezullimit të dakorduar, nëpunësi civil ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme ose në një pozitë ekuivalente”*, ndërsa neni 58 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka përcaktuar që: *“Pas përfundimit të pezullimit, përveçse kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, sipas këtij ligji, nëpunësi civil rikthehet në pozitën e mëparshme të punës ose në rast se pozita e mëparshme është e plotësuar përfundimisht, ai transferohet në një vend tjetër të së njëjtës kategori”*.

Bazuar në faktin që ankuesit i ka përfunduar mandati i funksionarit publik konkretisht si *“Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit”* në Komunën e Prishtinës në muajin dhjetor 2021, atëherë në kuptim të Vendimit me numër 14-112/02-0204360/17 të datës 16.08.2017 për pezullim të dakorduar dhe dispozitave ligjore të lartcekura, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesit i njihet e drejta për kthim në shërbimin civil, respektivisht Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore, janë të obliguar që ankuesin t’a kthejnë në vendin e tij të punës të cilin e ka mbajtur me akt emërim, apo në një pozitë ekuivalente nëse pozita që ka mbajtur nuk është pozitë e lirë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
Lënda me numër A.nr.316/2022.

Çlirim ZEKA  
  
Procesmbajtës

  
Eshref SHABANI  
  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

